




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVAT
ZYRA E PERMBARIMIT PRIVAT "ENFORCEMENT GROUP" SHPK

Adresa; Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla Nr.1, Pall, e Shoqërise "GORA" Kati 3, Ap.14, Tirane Tel: 0672022667
e-mail : enforcementgroup2014@gmail.com



Nr.635Regj

Tirane me 31.01.2023

URDHËR
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE
MBI AKSIONET E DEBITORIT



Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit.
Adresa : Tiranë.

Per dijëni : Shoqëria Klubi i Futbollit "Tirana" sh.a, me nr. NIPT L122200271
Adresa : Tiranë

Une Engjell Muskaj me detyre Permbarues Gjyqësor Privat prane Zyrës së Përmbarimit Privat "Enforcement Group" shpk, pasi studiova materialet e dosjes Nr.635 Regj, bazuar ne Urdhrin e Ekzekutimit Nr.1674 Akti, dt.31.03.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane,

KONSTATOVA

Se ne date 09.01.2015, prane Zyrës së Përmbarimit Privat "Enforcement Group" shpk është depozituar për ekzekutim, kërkesa e kreditorit Shoqëria International Trade sh.p.k, se bashku me titullin ekzekutiv Vendimi gjyqësor Nr.2972, date 04.07.2002 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin Nr.710., dt.11.06.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë me vendimin Nr.30, dt.28.01.2009, vendim për të cilin ka dalë Urdhri i Ekzekutimit Nr.1647 Akti, dt.31.03.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,
me pale e objekt :

- Kreditor : Shoqëria International Trade sh.p.k
- Debitor : Klubi i Futbollit Tirana sh.a me NIPT L122200271
- Objekti : Përbushje detyrimi/Pagim shume

Me ane te këtij titulli ekzekutiv eshte vendosur :

Me anë të këtij titulli ekzekutiv është vendosur:

- 1-Pranimi i pjesshëm kerkese padise së ngritur nga Shoqëria Tregtare "INTERNATIONAL TRADE" sh.p.k.
- 2- Detyrimin e palës së paditur Klubi i Futbollit "Tirana"sh.a t'i paguajë paditësit Shoqëria Tregtare "International Trade" sh.p.k. shumën prej 38,464,753 (Tridhjetë e tetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre) Lekë (shtesat + interesat për periudhën Janar 2000-31 Maj 2007), ndërsa pas kësaj periudhe sipas interesave bankare deri në ditën e ekzekutimit.
- 3-Shpenzimet gjyqësore në shumën 732,462 lekë i ngarkohen debitorit Klubi i Futbollit Tirana sh.a.

Per sa me siper:

Pasi kane kaluar afatet e parashikuara ne nenin 517 K.Pr.Civile, eshte konstatuar se debitori Klubi i Futbollit "Tirana" sh.a, me nr. NIPT L122200271 nuk e ka permbushur detyrimin sipas dispozitivit te titullit ekzekutiv dhe urdhrin te ekzekutimit. Ne baze te nenit 519 te K.Pr.Civile, nga ana e jone eshte marre vendimi i kalimit ne ekzekutim te detyrueshem duke vendosur masen e sekuestros mbi pasuritë e shoqërisë debitore Klubi i Futbollit "Tirana" sh.a, me nr. NIPT L122200271 në masën që do të jetë e nevojshme për shlyerjen e detyrimit.

Per kete arsye :

Në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile,

URDHËROJ:

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative ne aksionet e shoqerisë Klubi i Futbollit "Tirana" sh.a, me nr. NIPT L122900271 .
2. Aksionet e mesipërme do te qendrojne te sekuestruara deri ne nje urdher te dyte nga ana e Zyrës së Përmbarrimit Privat Enforcement Group shpk me përmbarrues gjyqesor z. Engjell Muskaj.
3. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet te na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
4. Per personat që bëhen pengesë ne zbatimin e ketij urdhëri do të merren te gjitha masat e parashikuara ne neni 508 e në vijim te K.Pr.Civile, si dhe ne rast se ka vend do te kerkohet ndjekje penale ne baze te dispozitave te Kodit Penal.
5. Ky urdhër mbahet e ju njoftohet palëve të cilat ne baze te nenit 610 te K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqesor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.

ZYRA E PERMBARRIMIT PRIVAT "ENFORCEMENT GROUP" SHPK

PËRMBARRUESI GJYQËSOR

ENGJELL MUSKAJ

